



## Republika e Kosovës

Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave  
Ministry of Local Government Administration

<b>Për :</b>	<b>Ragip Begaj, Kryetar i Komunës së Malishevës</b> <b>Rrahim Morina, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Malishevës</b>	
<b>Cc:</b>	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
<b>Përmes:</b>	<b>Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së</b> <b>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së</b>	
<b>Nga:</b>	<b>Shkelqim Jakupi, Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL</b>	<b>Datë:</b> 15.03.2018
<b>Lënda:</b>	Konfirmim i ligjshmërisë së Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës	<b>Nr. 020-338</b>
<b>Lloji i aktit</b>	Vendim	

I nderuar Kryetar,  
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendim Nr. 02/42 në parim për themelimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
I miratuar më datë: 02.03.2018
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 07.03.2018

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada - Government**  
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*  
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*  
*Ministry of Local Government Administration*

<b>Za:</b>	Ragip Begaj, gradonačelnik Opštine Mališevo Rrahim Morina, predsedavajući Skupštine opštine Mališevo	
<b>Cc:</b>	Jedinici za administrarciju dokumenata u MALS-u Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
<b>Preko:</b>	Ivan Todosijević, ministar MALS-a, <i>[Signature]</i> Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, <i>[Signature]</i>	
<b>Od:</b>	Shkelqim Jakupi, rukovodioca Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS - <i>[Signature]</i>	Datum, 15.03.2018
<b>Predmet:</b>	Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Mališevo	Br. 020-338
<b>Vrsta akta:</b>	Odluka	

Poštovani gradonačelnice,  
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opštine i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

Odluka br. 02/42 u načelju za osnivanje Odbora za obrazovanje, kulturu, omladinu i sport
Usvojena dana, 02.03.2018. godine;
Predložena na razmatranje u MALS-u dana, 07.03.2018. godine;

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni učinak. Ministarstvo administracije lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštine za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.





REPUBLIKA E KOSOVËS  
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/

Datë: 07.03.2018

Mbështetur në nenin 12 paragrafi 2 pika d, nenin 51 paragrafi 2 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në nenin 26 paragrafi 2 dhe 29 paragrafi 1 pika b të Statutit të Komunës së Malishevës nr.01/871, datë:12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 28.02.2018 mori këtë:

HYRJE SE ULAZNA (REGISTRACIONE)		
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË		
Ministria e Administrimit të Përbashkët Lokal		
Ministry of Local Government Administration		
Data	07.03.2018	
Datum		
Dato		
Shënimet	Nr. i Lendës	Drejçica
	-VI-	020-338

VENDIM  
NË PARIM PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR ARSIM, KULTURË, RINI DHE  
SPORT

1. Miratohet në parim vendimi për themelimin e Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Malishevës.
2. Bazuar në pikën 1 të këtij vendimi Komitetit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport do të jetë në përbërje prej pesë (5) anëtarëve;  
Dy (2) anëtar nga radhët e Nisma Socialdemokrate  
Një (1) anëtar nga radhët e PDK-së  
Një (1) anëtar nga radhët e LDK-së  
Një (1) anëtar nga radhët e VV-së
3. Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport duhet të hartojë planin e punës për vitin 2018, ndërsa pagesa do të bëhet vetëm për gjashtë (6) mbledhje të rregullta.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: Kuvendi përmes Kryetarit të Komunës dhe drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet;  
Arkivit të Komunës  
MAPL-së.

Kryesuesi i Kuvendit  
Rrahim Morina